



REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 18/05/2023
PRIMIJENG

01/700



Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë; 17/05/2023

Mbështetur në nenin 13, 58 (shkronja a, b dhe c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, Ligji nr.05/L-031, neni 53 neni 53 par. 53.1, 54 par.54.1 pika 1.3, neni 57 par 57.1, neni 58 par.58.2, neni 59 par.59.2 si dhe kërkesës nr.12/138, dt.17.05.2023, të parashtruar nga drejtori i drejtorisë për kulturë, rini dhe sport,

Kryetari i Komunës me datë 17.05.2023 mori këtë;

V E N D I M

I. Miratohet, kërkesa e drejtorisë për kulturë, rini dhe sport, nr.12/138, dt.17.05.2023, për anulimin e Konkursit me numër të referencës 12/622, të datës, 26.04.2023, për angazhimin e ekspertëve të jashtëm për komisionin vlerësues, për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, në Komunë ne Malishevës.

I I. Miratohet, kërkesa e drejtorisë për kulturë rini dhe sport, nr.12/139, dt.17.05.2023, për rishpalljen e konkursit në lidhje me përzgjedhjen e dy ekspertëve të jashtëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, të cilat kanë aplikuar sipas thirrjes publike të komunës së Malishevës, nr.01/614, dt.24.04.2023.

I I I. Në rast se gjatë procedurës së konkursit palët kanë pasur shpenzimet financiare, dhe nëse tashmë janë paguar, në llogari të KK-Malishevës, e që janë rezultat i akteve të anuluar, personave fizik apo juridik duhet që t'i kthehen mjetet financiare të paguara, konform nenit 59 par. 59.2, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative.

I V. Procedura administrative është bashkuar në këtë çështje, konform dispozitës së nenit 84 par.84.1, të Ligjit nr.05/L-031, për procedurën e përgjithshme administrative, ndërsa për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtoria për kulturë, rini dhe sport.

V. Ky vendim hyn në fuqi me datë, 17.05.2023.

Arsyetim

Komuna e Malishevës, konkretisht drejtoria për kulturë rini dhe sport, me datë 26.04.2023, ka shpallur konkursin nr.12/62, me lidhje me angazhimin e ekspertëve të jashtëm për nevojat e komisionit vlerësues, në lidhje me shqyrtimin dhe vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve, të Komunës së Malishevës, të cilat kanë aplikuar sipas thirrjes publike të shpallur nga ky organ. Me datë, 17.05.2023, sipas kërkesës nr.12/138, drejtoria për kulturë, rini dhe sport, ka parashtruar kërkesë me shkrim, me të cilën ka kërkuar që konkursi në fjalë, duhet të anulohet ngase sipas shkresës në fjalë, të katër kandidatët të cilët kanë konkurruar sipas konkursit të cekur nuk i plotësojnë kriteret e konkursit, ndaj kërkohet edhe anulimi i konkursit në fjalë. Ky organ pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, duke u bazuar edhe në njoftimin e komisionit nr.12/135, dt.17.05.2023, (njoftimin për vlerësimin e doses së ekspertëve bazuar në Thirrjen Publike të datës 26.04.2023, numër protokollit 01/622) kërkesën e drejtorisë e miratohet në tërësi si të bazuar dhe njëherit vendosi që konkursi numër: 12/62, dt.26.04.2023, të anulohet në tërësi, njëherit drejtoria për kulturë rini dhe sport, të përsërit procedurën e konkursit nga fillimi.

- Me sa u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.-

Udhëzimi Juridik: Kur dëgjohet vendimi nuk lejohet ankesë e veçantë.



Vendimi j u dorëzohet :

1. Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport,
2. Arkivit të komunës.